



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 43 Prot

Tiranë, më 01, 03, 2011

VENDIM Nr. 147, dt. 01.03.2011

Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë shqyrtoi konkluzionet e Grupit të Punës ngritur me Urdhër Nr. 114, datë 12.10.2010, të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe mbi bazën e diskutimeve në mbledhjene KKA, mori në shqyrtim propozimet në lidhje me ruajtjen *in situ* të strukturave të gjetura në sheshin e ndërtimit me adresë Sheshi "1 Maji", Rruga "Prokop Meksi", si më poshtë:

- I. Ruajtje e plotë e strukturave arkeologjike të zbuluara duke mos lejuar vazhdimin e procesit të ndërtimit.
Ky variant do të kërkonte shpronësim të plotë të një sipërfaqje prej rreth 3,000 m² nga buxheti i shtetit, si edhe fonde te tjera nga buxheti i shtetit për të siguruar ruajtjen dhe konservimin e gjetjeve arkeologjike, për të garantuar:
 - a. Mbrojtjen nga niveli i lartë i ujit nëpërmjet mbajtjes në punë në mënyrë të vazhdueshme 24 orë, të një sistemi pompash ose ndërtimin e një strukture prej beton armeje me thellësi minimale prej 12 m në të gjithë perimetrin e sheshit.
 - b. Mbulimin e sipërfaqes me substancë arkeologjike për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë.
 - c. Sigurimin e fondeve për konservimin me qëllime muzeale dhe të vizitueshmërisë.

Duke marrë në konsideratë kostot e papërbalueshme për buxhetin e shtetit dhe MTKRS, u kalua në variantin e dytë.

- II. Ruajtje pjesore e strukturave arkeologjike të zbuluara duke u përqendruar tek ruajtja e sistemit infrastrukturor (rrugë dhe kanalizime), si dhe dy ambiente zejtarie (fabrika e leshit dhe godinë banimi e



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

periudhës helenistike), duke lejuar ndërtimin me kusht ndryshimin e projektit duke iu përshtatur kësaj zgjidhjeje.

Anëtarë të Grupit të Punës kërkuan që të rritej maksimalisht sipërfaqja dhe volumet e substancës arkeologjike që do të ruhen, duke propozuar një variant të tretë.

- III. Ruajtje pjesore e strukturave arkeologjike të zbuluara e përqendruar në insulën që rrethohet nga tre anët me rrugë infrastrukturore dhe brenda saj do të bëhet një përzgjedhje për strukturat që do të ruhen në bazë të periudhave dhe vlerave që ato përfaqësojnë.

Në këtë variant lejohet ndërtimi duke bërë përshtatjet përkatëse në projektin ndërtimor nga ana e investitorit. Kjo zgjidhje nuk kërkon fonde nga buxheti i shtetit.

Për të siguruar një kompesim të shpenzimeve të investitorit për gërmimet arkeologjike, konservimet, humbjen e sipërfaqes së ndërtimit si dhe kostot shtesë që do të vijjnë si rezultat i ndryshimit të projektit ndërtimor, përfaqësues të grupit të punës do t'i kërkojnë Bashkisë Durrës dhe KRRTRSH, të shihet mundësia që kompesimi të bëhet me një shtesë prej dy kate mbi atë të miratuar nga KRT e Bashkisë Durrës.

Mbas shqyrtimit të varianteve të sipërpërmendur, KKA në mbledhjen Nr. 18, të datës 01.03.2011,

VENDOSI:

- I. Investitori të përgatisë projekt-ide në dy variante për mbrojtjen dhe ekspozimin e njësive arkeologjike që do të ruhen *in situ*.
- II. Në projekt-ide duhet të merret në konsideratë krijimi i një ambienti të



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

me hyrje të veçantë për qëllime të vizitueshmërisë.

- III. Pjesë e projektit do të jetë konservimi dhe restaurimi i njësive arkeologjike që do të vendoset të ruhen .
- IV. Të gjitha shpenzimet, në bazë të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), do të përballohen nga investitori.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FERDINAND XHAFERAJ

MINISTËR



SEKRËTAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al